



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 30

2001

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8792 datë 10.5.2001	Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave.....	909
Ligj nr.8793 datë 10.5.2001	Për parashikimin e kamatëvonesave të kontributeve të paderdhura për sigurimet shoqërore.....	914
Ligj nr.8795 datë 14.5.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Export Credit Bank të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për Riskedulimin e Borxhit”.....	915
Vendim i KM nr.183, datë 30.3.2001	Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”.....	918
Vendim i KM nr.311, datë 12.5.2001	Për një ndryshim në strategjinë e ristrukturimit të Bankës së Kursimeve, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.407, datë 27.7.2000	940

Vendim i KM nr. 313, datë 12.5.2001	Për dhënie fond ndihme Partisë “Lëvizja monarkiste demokrate shqiptare”.....	940
Vendim i KM nr.314, datë 12.5.2001	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.8, datë 13.1.2000 “Për një shtesë në vendimin nr.378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte, pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”.....	941
Vendim i KM nr.327, datë 17.5.2001	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës.....	941
Vendim i KM Nr.328, datë 17.5.2001	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrogzhinë-Lushnjë”, në rrethet e Kavajës e të Lushnjës.....	946
Vendim i KM nr.329, datë 17.5.2001	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Milot-Lezhë”, në rrethin e Lezhës.....	954
Udhëzim nr.4, datë 17.5.2001	Për një ndryshim në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.....	955
Vendim i GJ K nr. 33, datë 9.5.2001	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes “por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera” në fjalinë e dytë të nenit 23 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.....	956
Vendim i GJ K nr. 43, datë 18.5.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të nenit 4 të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha””, ndryshimin e paragrafëve të dytë e të tretë të nenit 1 të të njëjtit ligj dhe shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.....	959

LIGJ
Nr. 8792, datë 10.5.2001

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1
Qellim

Ky ligj ka për qëllim krijimin e Qendres së Përpunimit të të Dhënave dhe përcaktimin e 5 rregullave për sistemin e trajtimit të informatizuar të të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë operative të zyrave qendrore e vendore të Policisë së Shtetit.

Neni 2
Përkufizime

1 .Ne kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtme kuptojmë:

a) “Bankë të dhënash” është tërësia e të dhënave dhe e informacioneve për personat dhe sendet e organizuara, sipas disa kritereve që lehtësojnë trajtimin e tyre;

b) “Hyrje” është veprim i cili nëpërmjet kompjuterit lejon marrjen e të dhënave dhe informacioneve që përmban banka e të dhënave;

c) “Trajtim” është veprimi ose tërësia e veprimeve që kanë të bëjnë me mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, përpunimin, ndryshimin, seleksionimin, nxjerrjen, krahasimin, përdorimin, ndërlidhjen, bilokimin, komunikimin, përhapjen, fshirjen e të dhënave dhe informacioneve;

ç) “E dhënë” është çdo lajm i vecantë për një person fizik, juridik dhe send;

d) “Informacion” është bashkësia e të dhënave për një person, fizik, juridik, dhe send;

dh) “Informacion policor” është bashkësia e të dhënave, të cilat, në zbatim të parimeve kushtetuese, lejojnë pothuajse të kryejë detyrat e caktuara nga ligji për Pothuajse të Shtetit, nga Kodi Penal dhe ai i Procedurave Penale dhe nga ligjet e tjera për ruajtjen dhe sigurinë publike;

e) “Përgjegjës” është zyra përkatëse e Ministrisë së Rendit Publik dhe personi fizik, i garkuar për trajtimin e të dhënave;

ë) “Qender e përpunimit të të dhënave” është tërësia organike e personave ose e sendeve, të garkuara për trajtimin e të dhënave dhe të informacioneve dhe për përhapjen e tyre, në bazë të Ormës së përcaktuar në këtë ligj;

f) “Operator terminalist” është ai që kryen lidhjen telematike me bazën e të dhënave për të tur, për të azhurnuar, për të fshirë ose për të marrë të dhëna;

g) “Përdorues” është ai që kryen lidhjen telematike me bankën e të dhënave, vetëm për të arë informacione;

gj) “Fjalëkalim” është mënyra e njohjes nga kompjuteri qendër i operatorëve terminalistë dhe i përdoruesve të autorizuar;

h) “Prejardhës” është enti ose zyra e cila është burimi i informacionit që do të futet në bankën e të dhënave;

i) “Pronar” është zyra që ka kryer futjen e të dhënave dhe të informacioneve dhe që është e vetmja e autorizuar për të bërë azhurnimin dhe fshirjen e të dhënave dhe të informacioneve;

j) “Software bazë” është bashkësia e programeve ndërvepruese që bëjnë të mundur funksionimin e kompjuterit;

k) “Dokument zyrtar” është dokumenti që permban shenjën e entit ose të zyrës prejardhëse të të dhënave dhe të informacioneve objektive;

l) “Formë anonime” është paraqitja e të dhënave në mënyre të tillë që të mos lejojë identifikimin e një personi ose të një objekti;

II) “Sistemi i trajtimit të informacionit” është veprimi që kryhet për mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, përpunimin, ndryshimin, përzgjedhjen, nxjerrjen, krahasimin, përdorimin dhe fshirjen e të dhënave e të informacioneve.

Neni 3 **Organizimi**

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit krijohet Qendra e Përpunimit të të Dhënave e cila, duke përdorur teknikat informatike, bën mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave dhe të informacioneve për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e krimeve.

Në krye të Qendrës së Përpunimit të të Dhënave është drejtori dhe një zëvendës drejtor

2. Banka e të dhënave është një dhe e përbashkët për të gjitha strukturat e policisë

3. Qendra e Përpunimit të të Dhënave është në funksion të sigurisë publike dhe të Policisë Gjyqësore

4. Personeli i Qendrës së Përpunimit të të Dhënave pajiset sipas ligjit, me një vërtetim për njohjen e informacionit të kiasifikuar

5. Në mjediset e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave lejohet të futet, për nevoja shërbimi, me autorizim të veçantë, vetëm personeli i Policisë së Shtetit ose persona të tjerë të autorizuar për përmbushjen e detyrave të tjera të ligjshme

Neni 4 **Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit**

1. Drejtori përgjigjet për drejtimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave Si në aspektin tekniko-organizativ ashtu edhe administrativ

2. Ai përgjigjet përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për veprimtarinë e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave

3. Përveç sa më sipër ai:

a) bashkërendon veprimtarinë e seksioneve;

b) autorizon hyrjen në bankën e të dhënave;

c) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit;

c) organizon ngritjen e kurseve të vecanta për kualifikimin e operatoreve, terminalistëve dhe përdoruesve;

d) i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit azhurnimin e sitemit informativ për aspektet hardware e software;

dh) me kërkesë me shkrim të zyrave dhe të personave të autorizuar, pas verifikimeve të nevojshme, jep përgjigje me shkrim për hyrjet e paligjshme në bankën e të dhënave dhe për përdorimin e informacioneve jo për qëllimet e parashikuara në pikëri 1 të nenit 3.

Neni 5 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Zëvendës drejtorit**

1. Zëvendës drejtori zëvendëson drejtorin në mungesë. Ai duhet të ketë kualifikim tekniko informatik.

2. Ai përgjigjet për respektimin e procedurave nga operatorët e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave.

3. Ai i propozon Drejtorit programe të reja, me karakter administrativ ose statistikor dhe zgjidhje të reja për sistemin informativ.

Neni 6
Procedurat teknike

Procedurat e hyrjes, të mbledhjes së të dhënave dhe të informacioneve, të komunikimit, të futjes, të korrigjimit, të fshirjes dhe të plotësimit të të dhënave dhe të informacioneve, të regjistruara në arkivat magnetike të Qendrës së Përpunimit të të Dhënave, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 7
Kushtet paraprake të futjes së të dh

Në bankën e të dhënave mund të futen vetëm të dhëna dhe informacione nga dokumente zyrtare të policisë ose të institucioneve të administratës publike, si dhe vendimet gjyqësore.

Neni 8
Komisioni teknik

1. Me urdhër të Ministrit të Rendit Publik krijohet, në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, një komision teknik i cili ka për detyrë të caktojë kriteret dhe format teknike që duhet të zbatojë Qendra e Përpunimit të të Dhënave gjatë administrimit dhe mirëmbajtjes së bankës së të dhënave.

2. Komisioni teknik, përbërja e të cilit vendoset me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, ushtron edhe kontroll teknik për respektimin e dispozitave, të përcaktuara në pikën 1, nga personeli i Qendrës së Përpunimit të të Dhënave.

Neni 9
Futja e të dhënave dhe e informacioneve në Qendrën e Përpunimit të të Dhënave

1. Ndalohej të merren dhe të futen në bankën e të dhënave informacione dhe të dhëna për persona vetëm për arsye race, seksi, besimi fetar, mendimi politik, për përkrahje të lëvizjes Sindikaliste, mendimi kulturor dhe si anëtar i organizatave të mësipërme.

2. Merren informacione për veprimet ose pozita bankare, përse kërkohet nga hetimet e Policisë Gjyqësore dhe me mandat të veçantë të shkruar të autoritetit gjyqësor, pa u dhënë mundësinë organeve përgjegjëse të ndërmarrjeve të kreditit e financiare ose të instituteve publike të kreditit të kundërshtojnë për arsye të ruajtjes së sekretit.

3. Nëse gjatë gjykimit të një çështjeje kur gjyqtari e gjykon të nevojshme kryerjen e Verifikimeve pranë bankës së të dhënave, ai ngarkon me këtë detyrë oficerin e Policisë Gjyqësore.

Neni 10
Ruajtjen e hyrjes së të dhënave

1. Hyrja në bankën e të dhënave u nënshtrohet normave të veçanta të sigurisë për ruajtjen e paprekshmerisë dhe për azhurnimin e tyre.

2. Normat e parashikuara në pikën e mësipërme parashikojnë edhe që kompjuteri qendror të njohë terminalët, çdo operator terminalist dhe çdo përdorues nëpërmjet programeve të veçanta.

3. Njohja dhe regjistrimi i operatorëve terminalistë dhe i përdoruesve kryhet me përdorimin e fjalëkalimeve për hyrjen në bankën e të dhënave. Fjalëkalimet cilësohen sekrete dhe janë vetjake. Këto fjalëkalime u lëshohen nga Qendra e Përpunimit të të Dhënave personave që kanë ndjekur kurse të posaçme kualifikimi, sipas shkronjës “c” të pikës 4 të nenit 4.

4. Hyrja në të dhënat dhe informacionet lejohet ose pengohet me programe të veçanta elektronike.

Neni 11
Hyrja te të dhënat dhe informacionet

1 .Hyrja në bankën e të dhënave për qëllimet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 3 u lejohet vetëm oficerëve dhe agjenteve të Policisë Gjyqësore dhe të sigurisë publike, që bëjnë pjesë në forcat e policisë së Shtetit dhe oficerëve të Shërbimit Informativ Shtetëror, të pajisur me fjalëkalimin e parashikuar, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 10.

2. Agjentet e Policisë Gjyqësore, kur nuk e kanë fjalëkalimin, mund të hyjnë të të dhënat dhe informacionet, për qëllimet e përcaktuara në nenin 3, vetëm nëse janë pajisur me autorizim pas kërkesës me shkrim drejtuar operatorit terminalist ose përdoruesit nga përgjegjësit e shërbimit ose të zyrës ku bëjnë pjesë.

3 Kërkesa me shkrim, e parashikuar në pikën e mësipërme nuk kërkohet kur hyrja e të dhënat vendoset gjatë veprimeve të policisë, të zhvilluara nga përgjegjësi i zyrës së shërbimit ose i zyrës ky bën pjesë kërkuesi

4. Drejtori 1 Qendrës së Përpunimit të të Dhënave në mbështetje të pikës 4 të nenit 4 dhe të së pikës 3 të nenit 10 1 jep fjalëkalimin operatorit terminalist ose përdoruesit me kërkesë të përgjegjësit të shërbimit ose të zyrës ku ata bëjnë pjesë

5. Marrja e të dhënave dhe e informacioneve të ruajtura në bankën e të dhënave i lejohet autoritetit gjyqësor vetëm për të kryer verifikimet e nevojshme për procedime penale të filluara dhe brenda kufijve të vendosur nga Kodi i Procedurës Penale.

Neni 12
Transmetimi jashtë shtetit i të dhënave dhe i informacioneve

1 .Të dhënat dhe informacionet mund t'u komunikohen policive të shteteve të tjera në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, me kusht që në shtetin kërkuar këto të dhëna dhe informacione të trajtohen dhe të ruhen, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

2. Te dhënat dhe informacionet e përmendura në pikën e mësipërme mund të trajtohen vetëm nga autoritetet përkatëse të shtetit kërkuar.

3.Të dhënat dhe informacionet e përmendura në pikën 1 mund t'u ritransmetohen personave të tjerë ose shteteve të tjera vetëm pas një autorizimi me shkrim nga autoriteti përkatës shqiptar.

4.Të dhënat dhe informacionet e kërkuara nuk u komunikohen policive të shteteve të tjera kur ekziston detyrimi i ruajtjes së sekretit, kur kanë të bëjnë me akte të cështjeve në hetim të kryera nga prokurori dhe Policia Gjyqësore, në përputhje me nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 13
Përdorimi i informacionit

1. Ndalohet përdorimi i të dhënave dhe i informacioneve të marra nëpërmjet hyrjes në bankën e të dhënave për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të nenit 3.

2. Ndalohet transmetimi i të dhënave dhe i informacioneve zyra, i enteve ose i subjekteve të nryshme nga ato të parashikuara në nenet 11 dhe 12 të këtij ligji.

3. Ndalohet çdo qarkullim informacioni brenda administratës publike, jashtë rasteve të parashikuara në nenin 1.

4. Të dhënat dhe informacionet, të ruajtura në bankën e të dhënave, mund të përdoren gjatë procedimeve gjyqësore ose administrative, vetëm duke marrë burimet prejardhëse.

5. Kur gjatë një procedimi juridik ose administrativ vërtetohet se të dhënat dhe informacionet janë të gabuara ose të paplota, ose të trajtuara në kundërshtim me parimet e këtij ligji, autoriteti procedues njofton për këtë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Komisionin e Përhershëm të Rëndit e SHISH-it të Kuvendit.

Neni 14
E drejta për ankim

1. Personi, të cilit i referohen të dhënat e futura në bankën e të dhënave, nëse vëren se ekzistenca e të dhënave vetjake për të dhe komunikimi i tyre në formë të kuptueshme, është trajtuar, ose në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, i paraqet kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për fshirjen fizike ose kalimin në formë anonime të të dhënave të tij vetjake.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së shtetit pasi bën verifikimet e duhura, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës vë në dijeni të interesuarin për vendimin e marrë.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit mund të mos i përgjigjet kërkesës së bërë në rast se kjo dëmton veprimet për ruajtjen e rendit, te sigurisë publike ose parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit.

3. Personi që merr dijeni për praninë e të dhënave vetjake, edhe nëse ato janë të trajtuara në formë të paautomatizuar, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, mund t' i kërkojë gjykatës së rrethit gjyqësor korrigjimin, plotësimin, fshirjen fizike, ose kalimin në formë anonime të këtyre të dhënave.

Neni 15
Banka të tjera të dhënash

1. Çdo administratë publike, ent, ndërmarrje, shoqatë ose person privat i cili, për qëllime të ndryshme, me përjashtim të atij vetjak, kryen ttrajtimin e të dhënave dhe të informacioneve për persona të ndryshëm duhet të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Njoftimi duhet brenda tridhjetë ditëve nga fillimi i trajtimit, kurse afati për trajtimet e nisura është gjashtëdhjetë ditë nga hyrja në fliqi e këtij ligji.

3. Përfshihet nga detyrimi i njoftimit Shërbimi Informativ Shtetëror.

4. Për parandalimin dhe goditjen e krimit, parashikuar në pikën 1 të nenit 3, përgjegjësit e tjera shërbimeve qendrore dhe të zyrave të policisë kriminale të drejtorive të qarqeve mund të marrin informacione nga administrata publike dhe nga entet publike e private që ofrojnë shërbime publike kërkesën me shkrim.

Neni 16
Sanksionet

Çdo person që hyn, komunikon ose i përdor të dhënat dhe informacionet e bankës së të dhënave të policisë në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Neni 17
Dispozita kalimtare

Në pritje të përfundimit të rrjetit të koinunikimit, për një periudhë prej një viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të dhënat dhe informacionet mund të futen në bankën e të dhënave nga operatorët terminalistë që punojnë në mjediset Qendres së Përpunimit të të Dhënave ose në Drejtorinë e Policisë së Tiranës.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në ftiqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3025, date 24.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

LIGJ
Nr.8793, datë 10.5.2001

PER PARASHIKIMIN E KAMATEVONESAVE TE KONTRIBUTEVE TE PADERDHURA
PER SIGURIMET SHOQERORE

Ne mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetesh,

KUVENDI:
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Parashkruhen detyrimet e ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqerive tregtare me kapital tërësisht shtetëror për kamatvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore, të papaguara deri në datën 31.12.2000.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3029, date 24.5.2001 te Presidentit të Republikës së Shqipëri Rexhep Meidani

LIG J
Nr.8795, date 14.5.2001

PER RATIFIKIMIN E “MARREVESHJES NDERMJET EXPORT CREDIT BANK TE
TURQISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES TE SHQIPERISE PER RISKEDULIMIN E
BORXHIT”

Ne mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Export Credit Bank të Turqisë dhe Qeverisë Se Republikës të Shqipërisë për riskedulimin e Borxhit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3030, date 24.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Rexhep Meidani

MARREVESHJE
PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT NDERMJET EXPORT CREDIT BANK TE TURQISE DHE
QEVERISE SE REPUBLIKES TE SHQIPERISE

Me anën e kësaj Marreveshjeje Riskedulimi, Export Credit Bank e Turqise (me poshtë e quajtur Turk Eximbank) dhe Qeveria e Republikës Se Shqiperise, perfaqesuar nga Ministria e Financave e Shqiperise (me poshte e quajtur MF), bien dakord të riskedulojne borxhet që rrjedhin flga Marreveshja e Kredisë e dates 1.2.1991, nënshkruar ndërmjet Turk Eximbank dhe Bankës Se Shtetit Shqiptar per Marrëdhënjet me Jashtë dhe nga Lehtësirat e Sigurimit (Insurance Facility) dhënë Bankes së Shtetit shqiptar nga Turk Eximbank.

Tani, per këtë arsye, ne frymën e miqësisë dhe të bashkëpunimit ekonomik që ekziston fldërmjet dy vendeve, palet bien dakord si me poshte:

1. Me këtë Marrëveshje Riskedulimi, Qeveria e Republikës së Shqiperise merr persipër të gjitha detyrimet financiare prej 17,574,769.22 USD, që rrjedhin nga Marrëveshja e Kredisë e permendur me lart dhe nga Lehtësirat e Sigurimit (Insurance Facility).

2. Përbërja e shumës së mësipërne të riskeduluar me këtë Marrëveshje Riskedulimi është Si flë poshtë:

a. 13,865,328.3 USD është shurna e papaguar e principalit sipas Marrëveshjes se Kredisë se përmendur më lart,

b. 719,444.74 USD është shuma e interesit të papaguar sipas Marrëveshjes së Kredisë së permendur me lart,

c. 2,989,996.25 USD është shuma e papaguar Turk Eximbank-ut per Lehtësirat e Sigurimit (Insurance Facility).

3. Periudha e maturimit, sipas kësaj Marrëveshjeje Riskedulimi, është pesëmbëdhjete vjet, duke përfshirë pese vjet grace. Kështu, MF do te paguajë 17,574,769.22 USD me njëzetë e një këste te njepasnjeshme gjashtemujore, që kapin shumën prej 836,893.77 USD (me përjashtim të kështit të funclit i cili është 836,893.82 USD)

4. Per cdo kësht do të lëshohet një Note Premtimi (Promissory Note) üë formen e paraqitur në Aneks. Ne këtë kuptim, do të lëshohen gjithsej njezet një Nota Premtuese. Data e lëshimit të Notave Premtuese do të jete data e ratifikimit te kësaj Marrëveshjeje Riskedulimi nga Parlamenti i Republikës së Shqiperise. Nota e pare Premtuese do të paguhet pesë vjet pas dates së lëshimit të këtyre Notave Premtuese. Shuma e principalit dhe e interesit që do të paguhet, si edhe ilogaria në të cilën do të kryhet pagesa, do t'i njoftohet MF-së 30 ditë përpara dates së pageses.

5. Pagesat e interesit per këto Nota Premtuese do të bëhen cdo gjashte muaj, duke filluar nga data e lëshimit te Notave Premtuese. Ne këtë kuptim, pagesa e pare e interesit do të bëhet gjashte muaj nga data e lëshimit te Notave Premtuese. Perqindja e interesit që do të zbatohet per Notat Premtuese do te jete LIBOR gjashtemujor plus 0.50.

6. Ne oftë se rezulton ndonjë shumë e papaguar lidhur me kete Marrëveshje Riskedulimi dhe kjo shumë nuk paguhet brenda 15 ditësh pune, atëhere do të ngarkohen interes-vonesa me LIBOR plus 1.5% në vit, duke filluar nga data në te cilën duhej të ishte kryer pagesa den në datën e realizimit të kesja pagine.

7. Dispozitat e kesaj Marreveshjeje Riskedulimi konsiderohen si pjese perberese e Marrëveshjes së Kredisë së dates 1.2.1991 dhe e amendamenteve të kryera me pas. Per problemet e trajtuara në kete Marrëveshje Riskedulimi, do te zbatohen dispozitat e kesaj Marrëveshjeje, ndërsa per problemet që nuk jane trajtuar në kete Marrëveshje Riskedulimi, dispozitat Marrëveshjes Se Kredisë së dates i .2.1991 do të vazhdojnë te zbatohen derisa te permbushen te gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Riskedulimit.

8. Kjo Marrëveshje Riskedulimi do të bëhet efektive pas nenshkrimit nga të dyja palët dhe:

- Marrjes së VKM per miratimin e kesaj Marreveshjeje Riskedulimi dhe te

Plotfuqishemërise, lëshuar nga Kryeministri dhe Ministri i Puneve të Jashtme te Republikës së Shqiperisë, që autorizon Ministrin e Financave të Republikës së Shqiperisë të nënshkruajë këtë Marreveshje Riskedulimi;

- Marrjes se Notave Premtuese nga Turk Eximbank;
- Pasi të dyja palet te kenë njoftuar njera-tjetrën se jane plotesuar të gjitha procedurat e brendshme që kërkohen nga ligjet ne fuqi te secilit vend.

Pasi të përmbushen kushtet e theksuara në këtë nen, Turk Eximbank, do t'i njoftojë MF-së datën e berjes efektive të kësaj Marreveshjeje Riskedulimi. e

9. E gjithë korrespondenca do t'i transmetohet MF-së nga Turk Eximbank në këtë adresë:

Ministria e Financave prin
Drejtoria e Borxhit
Bulevardi "Deshmoret e Kombit", No.1, Tiranë, Shqiperi Shte
Telefax:+ +355 4 229 200
++355 4228 494

Gjithë korrespondenca për Turk Eximbank-un do të dërgohet nga Ministria e Financave në këtë adresë:

Turk Eximbank
Country Credits I Division men
Mudaffa Caddesi, No.20 je
Bakanliklar Ankara 06100

Turkey
Telefax: + +90 312 425 75 47 ++90 3124257896

Nënshkruar ne Tiranë, Shqiperi me 6.12.2000
Në dy kopje origjinale në gjuhën angleze

Anastas Angjeli Faruk Bal
Kryetar i Komitetit Qeveritar të Bisedimeve të Ministër Shteti
Borxhit të jashtëm dhe Ministër i Financave

ANEKS NOTE PREMTUESE

USD.....

No:
Datë I /20

01. Per shumën e marrë, Ministria e Financave e Shqiperisë ("MF") me anën e kësaj Note me Premtuese premton që në mënyrë të pakthyeshme dhe t pakushtëzuar të paguaje në favor te Export ri e Credit Bank te Turqise INC. (Turk Eximbank) me adresë Mudafaa Cad. No.20, 06100 Bankanliklar,

Ankara, Turqi, shumën e pricipalit prej USD dhe t paguajë interes per shumën e principalit sic e theksohet me poshtë me LIBOR +0.5% ne vit. Kjo perqindje interesi nenkupton mesataren e t e LIBOR-it gjashtemujor të rrumbullakosur den te 1/16 e nje perqindeshit, të kuotuar nga të gjitha rsa bankat, sic paraqitet në faqen LIBO të REUTERS në orën 11.00. GMT dy ditë pune përpara dates së së fillimit të çdo periudhe interesi.

02. Kjo shumë principal do të paguhet në , me 2000.

03. Interesi per shumën e principalit, i llogaritur në bazë të numrit aktual të ditëve (përfshirë ditën e pare, por perjashtuar ditën e fundit dhe per nje vit 360 ditë, do të paguhet çdo gjashte muaj në..... më..... , tëçdo viti, duke fihluar më/...../ 20.

Data e fundit e pagesës së interesit është e njejte me datën e pagesës së principalit. Ne rats se kjo ëte ditë nuk është Ditë Pune, atëherë si e tillë do të shërbejë Dita tjetër e Punës që pason.

04. Ne rast se principal apo ndonjë shumë e interesit të kësaj Note Premtuese nuk paguhet ne datën e caktuar, periudha që fihlon në këtë date dhe që mbaron në datën në te cilën MF shlyen detyrimin e saj, do të ndahet ne periudha të njëpasnjeshme secila prej te cilave (me perjashtim të së parës) do të fillojë ditën e fundit të periudhës paraardhëse dhe kohëzgjatja e së cilës do të F-se përcaktohet nga Turk Eximbank. Gjate secilës prej ketyre periudhave të permendura me lart, shumë e

papaguar do të taksohet me interes LIBOR plus 15% në vit.

05. Për të gjitha pagesat e kryera do të zbatohet ky rend (i) interesi sipas paragrafit të katërt të kësaj Note Premtuese, (ii) interesi sipas paragrafit të tretë të kësaj Note Premtuese dhe (iii) principali.

06. Principali dhe interesi sipas kësaj Note Premtuese do të paguhet në monedhën në fuqi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës pa bërë zbritje për hogan të ndonjë takse apo detyrimi të cfarëdoq natyre në Shqip apo në cdo vend tjetër nëpërmjet të cilit është kryer pagesa. Në rast se të tilla detyrime janë vendosur, lexuesi i kësaj Note Premtuese bie dakord të paguaje këto shuma në mënyrë që Turk Eximbank të marrë shumën neto që do të kishte marrë nëse nuk do të kete ishin vendosur këto taksa.

07. Nëse ndonjë prej kësteve të interesit të kësaj Note Premtuese nuk paguhet në kohën dhe shumën e duhur, i gjithë principali dhe interesi i ilogarituar den në ditën e pagesës, do të paguhet menjëherë me kërkesën e zotëruesit të kësaj Note.

08. Lëshuesi i kësaj Note Premtuese heq dorë nga ankesat në rast mospagimi apo mosrespektimi të ke të kësaj Note Premtuese; po ashtu heq dorë nga imuniteti në rast të

ndjekjes ligjore dhe kjo heqje dorë nga imuniteti do të kryhet në përputhje me ligjet e Turqisë, Shqipërisë dhe Anglisë.

09. Pamundësia e zotëruesit për të ushtruar ndonjë prej të drejtave në ndonjë rast të vecantë, nuk përbën asnjë rast heqje dorë prej këtyre të drejtave.

10. Kjo Note Premtuese do të udhëhiqet dhe ndërtohet në përputhje me ligjet e Anglisë.

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

V E N D I M

Nr.183, datë 30.3.2001

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe në zbatim të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në listën e anekseve të dispozitave zbatuese të Kodit Doganor, të miratuar me vendimin nr.205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave shtohet edhe ky aneks:

“- Aneksi 4/2, i emërtuar “Lista e operacioneve të përpunimit ose të proceseve, që duhet t’i nënshtrohen mallrat me origjinë joshqiptare, në mënyrë që produkti përfundimtar të përfitoj statusin e origjinësshqiptare, në kuadër të skemës së përgjithshme të preferencave tarifore, që qeveria norvegjeze ka dhënë në favor të Shqipërisë”, që është dhënë në aneksin 1 të këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të nxjerrë udhëzimet e duhura, për njohjen e personave të interesuar me rregullat, sipas të cilave mallrat ë caktuara, që eksportohen nga Republika e Shqipërisë drejt Mbretërisë së Norvegjisë, do të vlerësohen se kanë origjinë shqiptare, si dhe për të përcaktuar procedurat e lëshimit të certifikatës së origjinës FORMA “A”.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa, që brenda 10 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të autorizojë një shtypshkronjë të specializuar, për shtypjen e formularëve FORMA “A”, sipas modelit dhe kushteve të përcaktuara në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ANEKS 4/2

LISTA E OPERACIONEVE TE PERPUNIMIT OSE PROCËSEVE QE DUHET T'I NENSHTROHEN MALLRAT ME ORIGJINE JO SHQIPTARE, NE MENYRE QE PRODUKTI PERFUNDIMTAR TE PERFITOJE STATUSIN E ORIGJINES SHQIPTARE NE KUADER TE SKEMES SE PERGJITHESHME TE PREFERENCAVE TARIFORE QE QEVERIA NORVEGJEZE KA AKORDUAR NE FAVOR TE SHQIPERISE.

Kodi HS	Pershkrimi i produktit	Punimi ose perpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjines
02.01	Mishi i gjedheve, i fresket apo i ftohte:	Prodhime me materiale te çdo kreu, perveç mishit te gjedheve, te ngrire te kreut No.02.02
02.02	Mishi i gjedheve, i ngrire	Prodhime me materiale te çdo kreu, perveç mishit te gjedheve, te fresket ose te ftohte te kreut No.02.01
02.06	Te brendeshmet e ngrenshme te gjedheve, derrave, deleve, dhive, kuajve, gomereve, mushkave apo hibridit te gomarices me kalin, te fresketa, te ftohta apo te ngrira	Prodhime me materiale te çdo kreu, perveç karkasave te kreut No.02.01 deri 02.05
02.10	Mishi dhe te brendeshmet e ngreneshme te mishit, te kriposura, ne uje me kripe, te thara apo te tymosura; puder e ngrenshme e mishit dhe e te brendeshmeve te mishit	Prodhime me materiale te çdo kreu, perveç mishit dhe te brendeshmeve te kreut No.02.01 deri 02.06 dhe 02.08 ose melçive te shpendeve te kreut No.02.07
03.02 deri 03.05	Peshk, i ndryshem nga peshku i gjalle	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e Kapitullit 3, te perdorur, duhet te jene origjinueset
04.02, 04.04 deri 04.06	Produkte blegtorale	Prodhime me materiale te seicilit kre, perveç qumeshtit ose kremit te krereve No.04.01 ose 04.02
04.03	Dhalle, qumesht dhe krem i prere, kos, kefir dhe qumesht dhe krem tjetër te fermentuara apo te acidifikuara, nese jane apo jo te koncentruara apo qe permbajne sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese apo lende aromatizuese apo qe permbajne fruta, arra apo kakao shtese	Prodhime ne te cilat: - te gjithë materialet e kapitullit 4, te perdorur, duhet te jene teresisht origjinuese - çdo lloj leng frutash te kreut No.20.09 ose sucrosa e perdorur, duhet te jete origjinuese, dhe - vlera e çdo materiali te kapitullit 18, te perdorur, nuk duhet te kaloje vleren prej 40% te çmimit ex-works te produktit
04.08	Vezet e zogjve, jo ne guacke, dhe te verdhat e vezeve, te fresketa, te thara, te gatuara ne avull apo nga zierja ne uje, te dhena forme, te ngrire apo te ruajtur ndryshe, nese permbajne apo jo sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese shtese	Prodhime nga materiale te çdo kreu, perveç vezeve te zogjve te kreut No.04.07
ex 05.06	Kocka dhe palca e brireve, e papunuar	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e kapitullit 2, te perdorur, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 07.10 deri 07.13	Zarzavate te ngreneshme, te ngrira ose te thara, te ruajtura perkohesisht, perveç krereve No. ex 07.10 dhe ex 07.11, per te cilet rregullat pershkruhen me poshte	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet vegetable, te perdorur, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 07.10	Miser i embel (i pagatuar me avull ose zierje uji), i ngrire.	Prodhime nga misri, i embel, i fresket ose i ftohte.
ex 07.11	Miser i embel i ruajtur perkohesisht	Prodhime nga misri, i embel, i fresket ose i ftohte.
08.11	Fruta dhe arra, ta pagatuara apo te gatuara ne avull ose te zier ne uje, te ngrira, nese permbajne apo jo sheqer shtese apo lende te tjera embelsuese shtese: - Qe permbajne sheqer shtese - Te tjera	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e perdorura duhet te jene tashme origjinuese Prodhime ne te cilat te gjithë frutat ose arrat e perdorura duhet te jene teresisht origjinuese
08.12	Fruta dhe arra, te ruajtura perkohesisht (p.sh. nga gazi i dyoksidit te sul-furit, ne uje me kripe, ne uje sulfuror apo ne solucione te tjera ruajtese), por te papershtateshme ne ate gjendje per konsum te menjehershëm	Prodhime ne te cilat te gjithë frutat ose arrat e perdorura duhet te jene teresisht origjinuese

08.13	Fruta te thara, perveç atyre te kreut No.08.01 deri 08.06; perzierjet e arrave apo te frutave te thara te ketij Kapitulli	Prodhime ne te cilat te gjitha frutat ose arrat e perdorura duhet te jene teresisht origjinuese
08.14	Lekuret e agrumeve apo pjeprave (perfshire shalqinje), te fresketa, te ngrira, te thara apo te ruajtura perkohesisht ne uje me kripe, ne uje sulfuror apo ne solucione te tjera ruajtese.	Prodhime ne te cilat te gjitha frutat ose arrat e perdorura duhet te jene teresisht origjinuese
ex kapitulli 11	Produktet e industrise blujtese; malt, niseshte, inuline, gluteni i grurit, perveç kreut No. ex 11.06, per te cilat rregullat jane pershkruar me poshte:	Prodhime ne te cilat te gjitha drithrat, zarzavtet e ngreneshme, rrenjet dhe bulbet e kreut No.07.14 ose frutat e perdorura duhet te jene teresisht origjinuese
Kodi HS	Pershkrimi i produktit	Punimi ose perpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjines
ex 11.06	Miell, kokriza pluhur te thara leguminoze te kreut No. 07.13	Tharja dhe bluarja e zarzavateve leguminoze te kreut No.07.08
13.01	Lac; gome natyrale, rreshirat, gome-rreshirat dhe oleorreshirat (per shembull , balsamet)	Prodhime ne te cilat vlere e çdo materiali te kreut No.13.01, te perdorur, mund te mos kaloje 50% te çmimit ex-works te produktit
ex 13.02	Vanile oleoresin	Prodhime ne te cilat te gjitha materialet e perdorura, jane klasifikuar ne nje kre, te ndryshem nga ajo e produktit. Megjithate, materialet e klasifikuara ne kreun No 13.02 mund te perdoren, por vlere e tyre nuk duhet te kaloje 20% te çmimit ex-works te produktit.
15.01	Dhjam derri (perfshire sallon) dhe dhjami i shpendeve, ndryshe nga ai i kreut No. 02.09 apo 15.03 : - dhjamrat nga kockat ose mbeturinat - te tjera	Prodhime prej materialeve te çdo kreut, perveç atyre te krereve No.02.03, 02.06 ose 02.07, ose kockave te kreut No.05.06 Prodhime prej mishi ose prej te brendeshmeve te derrit, te klasifikuar ne kreun No.02.03 ose 02.06, ose mishit dhe te brendeshmeve te shpendeve, te klasifikuara ne kreun No.02.07
15.02	Dhjami i gjedheve, deleve apo dhive, ndryshe nga ato te kreut No.15.03: --dhjamrat nga kockat ose mbeturinat - te tjera	Prodhime prej materialeve te çdo kapitulli, perveç atyre te krereve No. 02.01, 02.02, 02.04 ose 02.06 ose kockave te kreut No.05.06 Prodhime ne te cilat te gjitha materialet me origjine prej kafsheve te kapitullit 2, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
15.04	Dhjamra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, te peshkut apo te sisoreve detare, nese jane apo jo te rafinuara, por jo te modifikuara kimikisht : - Fraksione solide - te tjera	Prodhime prej materiale te çdo kreut, perfshire te tjera materiale te kreut No.15.04 Prodhime ne te cilat te gjitha materialet me origjine prej kafsheve te kapitullit 2 e 3, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 15.05	Lanoline e rafinuar	Prodhime prej dhjamrave te leshit bruto, te kreut No.15.05

15.06	Dhjamra dhe vajra te tjera me origjine prej kafsheve dhe fraksionet e tyre, nese jane apo jo te rafinuara, por jo te modifikuara kimikisht : - Fraksione solide - te tjera	Prodhime prej materiale te çdo kreu, perfshire te tjera materiale te kreut No.15.06 Prodhime ne te cilat te gjitha materialet me origjine prej kafsheve te kapitullit 2, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 15.07 deri 15.15	Vajra te te gjitha llojeve dhe fraksionet e tyre, te rafinuar apo jo, por jo te modifikuar kimikisht: - Fraksione solide, pervec vajit te jojobas - te tjera, pervec - - Vaj tungu, dyll mersine dhe dyll japonez - - Ato te cilat perdoren per perdorim teknik ose industrial, te ndryshem me prodhimin e produkteve ushqimore per njerezit	Prodhime prej te tjera materialeve te kreut No.15.07 deri 15.15 Prodhime ne te cilat te gjitha materialet vegjetale, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 15.16	Yndyrna me origjine kafshesh ose vegjetale dhe fraksionet e tyre, te riestifikuara, te rafinuara ose jo, por jo me tej te pergatitura.	Prodhime ne te cilat te gjitha materialet me origjine prej kafsheve dhe vegjetale, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 15.17	Perzierje te ngreneshme te lengeta, te vajrave vegjetale te krereve No. 15.07 deri 15.15	Prodhime ne te cilat te gjitha materialet vegjetale, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
16.01	Sallam dhe produkte te ngjashme, prej mishi , prej te brendshmeve te mishit apo prej gjakut; pergatitjet ushqimore me baze te ketyre produkteve	Prodhime prej kafsheve te kapitullit 1
16.02	Mish, te brendshmet e mishit apo gjaku, te pergatitur apo ruajtur ne menyre tjeter	Prodhime prej kafsheve te kapitullit 1
Kodi HS	Pershkrimi i produktit	Punimi ose perpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjines
16.03	Ekstraktet dhe lengjet e mishit, peshkut apo krustaceve, molusqeve apo kafsheve te tjera jovertebrore ujore	Prodhime prej kafsheve te kapitullit 1. Megjithate te gjithë peshqit, krustacet, molusqet apo kafshet e tjera jovertebrore ujore, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
16.04	Peshk i pergatitur apo i konservuar; havjar dhe zevendesuesit e havjarit te pergatitur prej vezeve te peshkut	Prodhime ne te cilat te gjithë peshqit ose vezet e peshqeve, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
16.05	Krustacet, molusqet dhe kafshet e tjera jovertebrore ujore, te pergatitur apo te konservuar	Prodhime ne te cilat te gjithë krustacet, molusqet apo kafshet e tjera jovertebrore ujore, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
ex 17.01	Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose panxhar sheqeri dhe sarahozë kimikisht e paster, ne gjendje te ngurte, te aromatizuar apo te ngjyrosur.	Prodhime ne te cilet te gjitha materialet e perdorura jane klasifiku-ar ne nje kre te ndryshem nga i produktit. Megjithate, te gjithë aromatiozuesit apo ngjyronjesit te perdorur duhet te jene tashme origjinues
17.02	Sheqer tjeter, duke perfshire laktozen, maltozen, glukozen dhe fruktozen kimikisht te pastra, ne gjendje te ngurte; shurupet e sheqerit qe nuk permbajne lende aromatizuese dhe ngjyruese shtese; mjalte artificial, nese eshte apo jo i perzier me mjalte natyral; karamel : - Maltose dhe fruktoze kimikisht te pastra - Te tjera	Prodhime me materiale te çdo kreu, perfshire materialet e tjera te kreut No.17.02 Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e perdorur duhet te jene tashme origjinuese
ex 17.03	Melasat e rezultuara nga ekstragimi apo rafinimi i sheqerit, te aromatizuara ose te ngjyrosura	Prodhime ne te cilet te gjitha materialet e perdorura jane klasifiku-ar ne nje kre te ndryshem nga i produktit. Megjithate, te gjithë aromatiozuesit apo ngjyronjesit te perdorur duhet te jene tashme origjinues

17.04	Embslsirat prej sheqerit (perfshire cokollaten e bardhe), qe nuk permbajne kakao	Prodhime ne te cilet te gjithë materialet e perdorur nuk jane klasifikuar ne Kapitullin 17. Megjithate, te gjithë aromatozuesit apo ngjyronjesit te perdorur duhet te jene tashme origjinues
18.04	Gjalp kakao, yndyre dhe vaji	Prodhime ne te cilat te gjitha kokrrat e kakaos te perdorura duhet te jene teresisht origjinuese
18.06	Çokollatat dhe pergatitje te tjera ushqimore qe permbajne kakao.	Prodhime ne te cilet te gjithë materialet e perdorur jane klasifikuar ne nje kre tjetër, te ndryshem nga ai i produktit, por vlera e çdo materiali te Kapitullit 18, te perdorur, nuk kalon 40% te çmimit ex-works te produktit dhe qe i gjithë sheqeri i perdorur i kreut No. 17.01 duhet te jete tashme origjinues
19.01	Ekstrakt malti; pergatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtese apo ekstraktit te maltit, qe nuk permbajne kakao te llogaritur mbi nje baze totalisht te cyndyrosur ose qe permban me shume se 2% kakao sipas peshes, te llogaritur mbi nje baze totalisht te cyndyrosur, te paspecifikuara dhe te paperfshira diku tjetër; pergatitjet ushqimore te mallrave te krereve No. 04.01 deri 04.04, qe nuk permbajne kakao, te llogaritur mbi nje baze totalisht te cyndyrosur apo qe permbajne kakao ndaj peshes me pak se 5% ndaj peshes te kakaos pluhur, te paperfshira dhe te paspecifikuara diku tjetër : - Ekstrakt malti - Te tjera	Prodhime nga dritherat e Kapitullit 10 Prodhime ne te cilet te gjithë materialet e perdorur jane klasifikuar brenda kreut, te ndryshem nga ai i produktit. Megjithate, sheqeri i kreut No.17.01 nuk mund te perdoret
19.02	Brumrat, nese jane apo jo te gatuar apo te mbushur (me mish apo me substanca te tjera) apo te pergatitur ndryshe, te tilla si spageti, makaro-na, makarona pete, lasanje, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nese jane apo jo te pergatitur	Prodhime ne te cilat te gjithë dritherat (pervec grurit durum), mishit, te brendeshmeve, peshkut, krustaceve ose molusqeve, te perdorur, duhet te jene teresisht origjinuese
19.03	Tapioka dhe zevendesuesit e tij pergatitur nga niseshteja, ne formen e fetezave, kokrrave, margaritareve, toptash apo ne forma te ngjashme.	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e perdorura jane tashme origjinuese.

Kodi HS	Pershkrimi i produktit	Punimi ose perpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjines
19.04	Ushqimet e pergatitura fituar prej bymimit apo pjekjes se drithrave apo te produkteve te tyre (per shembull, feteza drithi); drithrat (ndryshe nga misri (si drith)) ne forme kokrrë apo ne forme fetezash apo kokrra te punuara ndryshe (pervec miellit dhe kokrrizave te miellit), te para-gatuara apo te pergatitura ndryshe, te paperfshira apo te paspecifikuara diku tjetër : - Qe nuk permbajne kakao - Qe permbajne kakao	Prodhime ne te cilat te gjithë materialet e perdorura jane tashme origjinuese. Prodhime prej materialeve te çdo kreu, perfshire materialet te tjera te kreut No.19.04, perjashtuar sheqer te kreut No.17.01, me kusht qe vlera e çdo materiali te Kapitullit 18, te perdorura, te mos kaloje 40% te çmimit ex-works te produktit.

19.05	Buke, torta, kek, biskotat dhe produkte te tjera te furretarit, nese permbajne apo jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh te nje lloji te pershtatshem per qellime farmaceutike, vaferet me shtresa, leter orizi dhe produkte te ngjashme	Prodhime prej materialeve te çdo kreu, perveç atyre te Kapitullit 11.
20.01	Zarzatat, frutat, arrat dhe pjese te tjera te ngrreneshme te bimeve, te pergatitura apo te ruajtura ne uthull apo ne acid acetik	Prodhime ne te cilet te gjithë frutat, arrat ose zarzatat, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
20.02	Domate te pergatitura apo te ruajtura ndryshe nga ne uthull apo ne acid acetik	Prodhime ne te cilet te gjithë domatet, e perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
20.03	Kerpudha dhe zhardhoku i kerpudhave, te pergatitura apo te ruajtura ndryshe nga ne uthull apo ne acid acetik	Prodhime ne te cilet te gjithë kerpudhat dhe zhardhoket e kerpudhave, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
20.04 dhe 2005	Zarzatat te tjera te pergatitura apo te ruajtura ndryshe nga ne uthull apo ne acid acetik, dhe te ngrira ose jo, ndryshe nga produktet e kreut No. 20.06	Prodhime ne te cilet te gjithë zarzatat, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese
20.06	- Fruta, arra, lekura frutash dhe pjese te tjera te bimeve, te ruajtura ne sheqer (te thara, te sheqerosura apo te kristalizuara)	Prodhime ne te cilet te gjithë zarzatat, frutat, arrat dhe te tjera pjese te pemeve, dhe i gjithë sheqeri i Kapitullit 17 duhet te jene tashme origjinuese.
20.07	Recelet, peltet e frutave, marmalatat, pure frutash apo arrash dhe brum frutash apo arra, qe jane pergatitje te gatuar, nese permbajne apo jo sheqer apo lende te tjera embelsuese shtese	Prodhime ne te cilet te gjithë frutat, arrat dhe i gjithë sheqeri i Kapitullit 17 duhet te jene tashme origjinuese.
20.08	Fruta, arra e pjese te tjera te ngrreneshme te bimeve, te pergatitura apo te ruajtura ndryshe, nese permbajne apo jo sheqer apo lende te tjera embelsuese shtese apo alkool, te paperfshira apo te paspecifikuara diku tjeter : - Fruta dhe arra te pergatitura jo me avull apo uje te zier qe nuk permbajne sheqer shtese, te ngrira. - Te tjera	Prodhime ne te cilet te gjithë frutat dhe arrat, te perdorura, duhet te jene teresisht origjinuese Prodhime ne te cilat te gjithë frutat, arrat, farerat dhe te tjera materiale te Kapitujve 8 dhe 9 dhe i gjithë sheqeri i perdorur ose pijet, alkoli etilic dhe uthulla e Kapitullit 17 ose 22 duhet te jene tashme origjinuese.
Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare, që jepet nga shkollat e larta shqiptare dhe diploma maqedonase e magjistratit që jepet nga shkollat e larta maqedonase, njihen në të dy vendet dhe sigurojnë të drejtën për të vazhduar studimet për doktoratë dhe punësim në territorin e të dy vendeve, në përputhje me specialitetin dhe kualifikimin e shënuar në to.

Neni 8

Diploma shqiptare e “Doktorit të Shkencave” dhe diploma maqedonase e “Doktorit të Shkencave”, që jepen në vendet respektive, njihen dhe konsiderohen ekuivalente dhe u japin zotëruesve të drejtën të ushtrojnë veprimtari profesionale në të dy shtetet, në përputhje me gradën e akorduar.

Neni 9

Palët do të shkëmbejnë informacion mbi sistemet e arsimit, mbi modelet e dokumenteve shtetërore për arsimin dhe gradat shkencore, si dhe do të informojnë njera-tjetrën për çdo ndryshim në fushën në fjalë.

Ato do të informohen në mënyrë të ndërsjellë për ndryshimet e bëra në legjislacionin e të dy palëve në fushën e arsimit dhe shkencës.

Neni 10

Palët përkrahin bashkëpunimin dhe informimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet ministrive përkatëse të arsimit dhe shkencës në fusha të interesit të përbashkët, si dhe atë të shkencave natyrore, të aplikuara, humane e sociale, si edhe shkëmbimin e planeve dhe programeve mësimore, të librave dhe teksteve shkollore.

Neni 11

Palët do të kujdesen që të gjitha çështjet në fushën e bashkëpunimit në arsim dhe shkencë të të dy shteteve të zgjidhen përmes bashkëpunimit dhe dialogut të ndërsjellë.

Neni 12

Palët përkrahin bashkëpunimin aktiv në kuadër të projekteve dhe programeve të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, UNESCO-s, nismave rajonale dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, iniciativave dhe programeve nga fusha e arsimit dhe shkencës.

Neni 13

Palët do të ndihmojnë dhe nxisin bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve të tyre arsimore dhe shkencore në kuadrin e programeve dhe projekteve ndërkombëtare e rajonale në fushën e shkencës, teknologjisë dhe zhvillimit.

Neni 14

Palët nxisin dhe favorizojë bashkëpunimin midis institucioneve arsimore në nivel lokal midis komunave, qyteteve të binjakëzuar etj.

Neni 15

Palët përkrahin realizimin e kontakteve dhe shkëmbimeve të nxënësve dhe studentëve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve kompetente të të dy palëve.

Neni 16

Në përputhje me legjislacionin e vet dhe në bazë të reciprocitetit, palët do të krijojnë kushte për lehtësimin e hyrjes dhe daljes së materialeve informative për arsimin, të mjeteve dhe pajisjeve didaktike, librave shkollorë etj.

Neni 17

Aktivitetet konkrete të kësaj Marrëveshjeje, kushtet financiare dhe kushtet e tjera për shkëmbim, përcaktohen me programe për bashkëpunim trevjeçar midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës së Republikës së Maqedonisë, me marrëveshje të ndara për bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis institucioneve dhe organizatave homologe në fushat përkatëse, si dhe programe plotësuese, të cilat nuk janë përcaktuar në këtë Marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimet e saj.

Neni 18

Për realizimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do të formojnë një komision të përbashkët prej 6 (gjashtë) personash; secila palë do të ketë nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të takohen periodikisht në territorin e të dy vendeve kontraktuese.

Neni 19

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë 5(pesë)-vjeçare dhe automatikisht do të vazhdojë për një periudhë të re 5(pesë)-vjeçare, në qoftë se asnjëra nga palët, përmes rrugëve diplomatike me letër, më vonë se 6 muaj para skadimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje, nuk paralajmëron anulimin e saj.

Anulimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do ta ndërpresë realizimin e programit realizues të nënshkruar ose ndonjë kontratë tjetër, të nënshkruar për realizimin e Marrëveshjes.

Neni 20

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e sjelljes së notës së dytë me të cilën palët përmes rrugëve diplomatike në mënyrë të ndërsjellë informohen, që janë realizuar procedurat e legjislacioneve kombëtare, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Shkup në datën 23.2.2001 në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, maqedone dhe angleze me tekstet ekuivalente. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e teksteve, do të vlejë teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë Shqiptare

Për Qeverinë Maqedonase

V E N D I M **Nr.328, datë 17.5.2001**

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RROGOZHINË-LUSHNJË”, NË RRETHET E KAVAJËS E TË LUSHNJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 21 dhe 27 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrogozhinë-Lushnjë”, në rrethet e Kavajës dhe të Lushnjës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të cilët do të shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelë që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një sipërfaqe të përgjithshme 17 223 m² tokë/arë vlerësuar me 750 dhe 1200 lekë/m², 86 m² ndërtesë vlerësuar me 22 500 lekë/m², objekt industrial vlerësuar me 7 397 065 lekë, truall ndërtimi 1460 m² vlerësuar me 3500 lekë/m², dru frutorë, agrume 4 rrënjë, vlerësuar me 4000 lekë/për rrënjë dhe 596 m² vreshtë vlerësuar me 134,5 lekë/m², mur rrethues vlerësuar me 50 000 lekë gjithsej. Vlera e përgjithshme për këtë shpronësim arrin shumën 33 275 215 lekë.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2001, në zërin “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2001.

6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

RRethi: Kavajë

Bashkia: Rrogozhinë

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogozhinë-Lushnjë

Lloji i pasurië: tokë bujqësore

1	2			3	4	5	6
Nr.	Emër	Pronar Atësi	Mbiemër	Nr.i parcelës	Sipërfaqe që shpronësohet	Çmimi për njësi L/m ²	Vlera lekë
1	Arif	Selman	Daja	259/3	760	1.200	912000
2	Muharrem	Mexhit	Tosku	259/2	996	1.200	1195200
3	Tasim	Ibrahim	Sina	259/11	173	1.200	207600
4	Liljana		Kashari	490/65	143	1.200	171600
5	Astrit	Jashar	Kashari	490/65	143	1.200	171600
6	Lumturi	Jashar	Dushku(Kashari	490/65	143	1.200	171600
7	Nuri	Jashar	Kashari	490/65	143	1.200	171600
8	Mimoza	Jashar	Daja (Kashari)	490/65	143	1.200	171600
9	Fisnike	Jashar	Skuqi (Kashari)	490/65	143	1.200	171600
10	Hazis	Jashar	Kashari	490/65	143	1.200	171600
11	Alfred	Jashar	Kashari	490/65	143	1.200	171600
12	Riza	Mahmut	Sina	490/60	95	1.200	114000
13	Ashim	Mahmut	Hoxha	490/59	115	1.200	138000
14	Adem	Mahmut	Hoxha	490/58	46	1.200	55200
15	Nazmi	Adem	Hoxha	490/52	27	1.200	32400
16	Përparim	Bajram	Gjuzi	491/57	167	1.200	200400
17	Kadri	Bajram	Gjuzi	491/56	81	1.200	97200
18	Petrit	Kadri	Gjuzi	491/55	47	1.200	56400
19	Sabri	Mustafa	Gjuzi	491/54	19	1.200	22800
20	Nazmi	Sabri	Gjuzi	491/53	62	1.200	74400
21	Rrapush	Rexhep	Gjuzi	491/52	66	1.200	79200
22	Bujar	Zenel	Gjuzi	491/51	45	1.200	54000
23	Zenel	Veli	Gjuzi	491/50	88	1.200	105600
24	Qerim	Veli	Gjuzi	491/49	103	1.200	123600
25	Elmaz	Veli	Gjuzi	491/48	111	1.200	133200
26	Shaban	Veli	Gjuzi	491/47	102	1.200	122400
27	Hidajet	Adem	Gjuzi	491/46	119	1.200	142800
28	Eduart	Adem	Gjuzi	491/45	48	1.200	57600
29	Qazim	Banush	Gjuzi	491/44	131	1.200	157200
30	Agim	Qazim	Gjuzi	491/43	119	1.200	142800

31	Xhelal	Qazim	Gjuzi	491/42	82	1.200	98400
32	Rrahman	Banush	Gjuzi	491/41	131	1.200	157200
33	Murat	Banush	Gjuzi	491/40	72	1.200	86400
34	Sulejman	Banush	Gjuzi	491/39	166	1.200	199200
35	Fatmir	Banush	Gjuzi	491/38	213	1.200	255600
36	Sefer	Sulejman	Gjuzi	491/37	29	1.200	34800
37	Ali	Çaush	Gjuzi	491/36	57	1.200	68400
38	Ndriçim	Çaush	Gjuzi	491/34	66	1.200	79200
39	Maliq	Çaush	Gjuzi	491/33	66	1.200	79200
40	Arif	Ali	Gjuzi	491/32	57	1.200	68400
41	Hekuran	Arif	Gjuzi	491/31	44	1.200	52800

RRETHI: Kavajë

Bashkia: Rrogozhinë

Lista e Personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogozhinë-Lushnje
Lloji i pasurië: tokë bujqësore

1 Nr.	2 Emër	3 Pronar Atësi	4 Mbiemër	5 Nr.i parcelës	6 Sipërfaqe që shpronësohet	7 Çmimi për njësi L/m2	8 Vlera lekë
42	Qemal	Beqir	Gjuzi	491/23	69	1.200	82800
43	Enver	Beqir	Gjuzi	491/30	46	1.200	55200
44	Ymer	Hysen	Gjuzi	491/28	76	1.200	9120
45	Hysen	Ymer	Gjuzi	491/27	38	1.200	
46	Reshat	Hysen	Gjuzi	491/26	51	1.200	45600
47	Bujar	Hysen	Gjuzi	491/25	55	1.200	61200
48	Fatmir	Musa	Gjuzi	491/24	71	1.200	66000
49	Qemal	Met	Gjuzi	491/22	63	1.200	75600
50	Mehmet	Mahmud	Gjuzi	491/21	57	1.200	68400
51	Mahmud	Mehmet	Gjuzi	491/20	31	1.200	37200
52	Isuf		Gjuzi	491/19	87	1.200	104400
53	Hatije	Halil	Gjuzi	491/18	136	1.200	163200
54	Shaban	Islam	Hoxha	491/15	100	1.200	120000
55	Haxhi	Shaban	Hoxha	491/14	63	1.200	75600
56	Hysen	Islam	Hoxha	491/13	140	1.200	168000
57	Reshit	Islam	Hoxha	491/12	197	1.200	236400
58	Kadri	Riza	Aliu	492/22	101	1.200	121200
59	Skënder	Sefer	Aliu	492/20	158	1.200	189600
60	Ismail	Sefer	Aliu	492/19	105	1.200	126000
61	Zija	Muharrem	Aliu	492/18	62	1.200	74400
62	Sali	Ahmet	Aliu	492/17	54	1.200	64800
63	Ibrahim	Ahmet	Aliu	492/16	94	1.200	112800
64	Sadete	Shaban	Gjini	492/15	64	1.200	76800
65	Riza(Ham)	Shaban	Gjini	492/14	86	1.200	103200
66	Sami	Met	Gjini	492/12	38	1.200	45600
67	Qerime	Beqir	Gjini	492/11	40	1.200	48000
68	Ymer	Arif	Gjini	492/10	40	1.200	48000
69	Mexhit	Ymer	Gjini	492/9	123	1.200	147600
70	Idriz	Din	Gjini	492/8	184	1.200	220800
71	Misir	Idriz	Gjini	492/7	84	1.200	100800
72	Taip	Kadri	Gjini	492/6	221	1.200	265200
73	Reshat	Kasem	Gjini	492/5	65	1.200	78000
74	Petrit	Kasem	Gjini	492/4	41	1.200	49200
75	Sherbet	Kasem	Gjini	492/3	81	1.200	97200
76	Zeqir	Maksud	Gjini	492/2	111	1.200	133200
77	Fatmir	Maksud	Gjini	492/1	122	1.200	146400
78	Refit	Zeqir	Gjini	492/0	284	1.200	340800
79	Bashkim	Sadik	Çela	496/34	296	1.200	355200
80	Telha	Hajdar	Proshka	496/35	396	1.200	475200
81	Kimete	Avdulla	Aliu	496/41	56	1.200	67200
82	Kafaze	Hajdar	Aliu	486/42	56	1.200	67200

83	Muharrem	Mexhit	Ballabani	496/43	56	1.200	67200
----	----------	--------	-----------	--------	----	-------	-------

Rrethi: Kavajë

Bashkia: Rrogozhinë

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogozhinë-Lushnjë

Lloji i pasurisë: tokë bujqësore

1	2			3	4	5	6
Nr.	Emër	Pronar Atësi	Mbiemër	Nr.i parcelës	Sipërfaqe që shpronësohet	Çmimi për njësi L/m2	Vlera lekë
84	Agron	Zyber	Xhafa	496/44	146	1.200	175200
85	Islam	Hazis	Xhafa	496/45	39	1.200	46800
86	Hatixhe	Shaban	Iljazi	496/46	230	1.200	276000
87	Abaz	Beqir	Ibrahimllari	496/37	217	1.200	260400
88	Natasha	Hashim	Halili	496/38	131	1.200	157200
89	Violeta	Xhavit	Ballabani	496/47	191	1.200	229200
90	Halime	Kalem	Ballabani	496/48	42	1.200	50400
91	Xhelal	Mahmud	Ballabani	496/49	42	1.200	50400
92	Shyqyri	Mahmut	Ballabani	496/50	138	1.200	165600
93	Mustafa	Ismail	Ballabani	496/51	45	1.200	54000
94	Sadushe	Qani	Ballabani	496/52	230	1.200	276000
95	Fatime	Ali	Ballabani	496/53	132	1.200	158400
96	Lindita	Tajar	Ballabani	496/54	39	1.200	46800
97	Qemal	Beqir	Gjuzi	496/55	36	1.200	43200
98	Ylli	Qazim	Gjuzi	496/56	46	1.200	55200
99	Rifan	Izet	Gjuzi	496/57	202	1.200	242400
100	Servete	Xhip	Proshka	496/36	260	1.200	31200
101	Flamur	Qemal	Avdiu	496/39	176	1.200	211200
102	Nazime	Sulejman	Daja	496/40	127	1.200	152400
		Shuma:			12.414		14.896.800

Mbyllet me numër rendor 102 (njëqind e dy)

Rrethi: Lushnjë

Bashkia: Lushnjë

Fshati: Thanasaj

Lista e Personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogzhinë-Lushnjë

Lloji i pasurisë: tokë bujqësore

1 Nr.	2 Emër	Pronar Atësi	Mbiemër	3 Nr.i parcelës	4 Sipërfaqe që shpronësohet	5 Çmimi për njësi L/m2	6 Vlera lekë
1	Shkëlqim	Mehmet	Lika	23/26	125	750	93750
2	Rexhep	Ali	Lika	23/25	520	750	390000
3	Emin	Mexhit	Sula	23/40	128	750	96000
4	Liman	Mexhit	Sula	23/38	128	750	96000
5	Rifan	Mexhit	Sula	23/39	62	750	46500
6	Qemal	Jaho	Sula	23/36	94	750	70500
7	Haxhi	Jaho	Sula	23/35	47	750	35250
8	Jonuz	Gani	Sula	23/31	42	750	31500
9	Bekdash	Gani	Sula	23/32	40	750	30000
10	Gani	Jonuz	Sula	23/28	70	750	52500
11	Fiqiri	Hekuran	Sula	23/27	23	750	17250
12	Zaje	Avdulla	Sula	23/25	58	750	43500
13	Osman	Hekuran	Sula	23/24	40	750	30000
14	Halil	Elmaz	Sula	23/17	60	750	45000
15	Mustafa	Elmaz	Sula	23/14	54	750	40500
16	Safet	Nuredin	Sula	23/9	10	750	7500
17	Sulltane	Ibrahim	Sula	23/10	92	750	69000
18	Mersin	Bajram	Sula	23/6	48	750	36000
19	Dervish	Sulejman	Sula	23/4	31	750	23250
20	Xhelal	Hysen	Sula	23/2	109	750	81750
21	Ylli	Hazis	Kasa	23/1	95	750	71250
22	Idriz	Ramazan	Sula	22/60	35	750	26250
23	Isa	Latif	Sula	22/56	199	750	149250
24	Muhamet	Latif	Sula	22/55	136	750	102000
25	Astrit	Rexhep	Sula	22/53	133	750	99750
26	Rroc	Sadik	Feti	22/51	52	750	39000
27	Adile	Isuf	Sula	22/50	210	750	157500
28	Xhafer	Hamid	Sula	22/48	173	750	129750
29	Selim	Hysen	Sula	22/47	158	750	118500
30	Hati	Ismail	Sula	22/46	186	750	139500
31	Rabije	Baki	Sula	22/45	159	750	119250
32	Dylaver	Hysen	Sula	22/44	229	750	171750
33	Isa	Hysen	Sula	22/43	174	750	130500
34	Vath	Xhaferr	Sula	22/41	397	750	297750
		Shuma:			4117		3.087.750

Mbyllet me numër rendor 34 (Tridhjetë e katër)

Republika e Shqipërisë

Rrethi: Lushnjë

Komuna: Çermë

Fshati: Çermë e Sipërme

Lista e Personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogzhinë-Lushnjë

Lloji i pasurisë së palujtshme: tokë bujqësore nr. (1-3)

1	2			3	4	5	6	7	8	9	10
	Pronar			Nr.i	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Vreshtë	Çmimi	Vlera	Vlera
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	parcelës	që shpronësohet	lek / m2	lekë	m2	njësi l/m2	në lekë	totale në lekë
1	Ymer	Demir	Kokja	237/25	363	750		363	250		
2	Xhafer	Ymer	Kokja	237/38	233	750		233	250		
3	Jonuz	Faik	Caka	237/35	30	750		0	250		
											469,500
					626			596			149000
		Shuma:									618,500

Mbyllet me numër rendor 3 (tre)

Republika e Shqipërisë

Rrethi: Lushnjë

Komuna: Dushk

Fshati: Dushk Peqin

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogzhinë-Lushnjë

Lloji i pasurisë së palujtshme: truall dhe ndërtesë nr.(1-2)

1	2			3	4	5	6	7	8
	Pronar			Nr.i	Sipërfaqe	Çmimi	Sipërfaqe	Çmimi	Vlera
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	parcelës	truall m2	lek / m2	ndërtese m2	lek / m2	në lekë
1	Arshin	Zija	Isufi	255/19	600	3500			2.100.000
2	Arshin	Zija	Isufi	255/20			86	22,500	1.860.600
		Shuma:			600		86		3.960.600

Mbyllet me numër rendor 2 (dy)

Republika e Shqipërisë

Rrethi Lushnjë

Komuna: Golem

Fshati: Golem i Madh

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogzhinë-Lushnjë

Lloji i pasurisë së palujtshme: truall, investime dhe dru frutore nr. (1)

1	2			3	4	5	6	7	8	9	10	11
	Pronar			Nr.i	Sipërfaqe	Çmimi	Sipërfaqe	Çmimi	Investime për	Agrume	Çmimi	Vlera
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	parcelës	truall m2	lek / m2	truall m2	lek / m2	rrethimin/lekë	(copë)	Lek/ m2	totale në lekë
1	Petraq	Kici	Kotici	67/11	336	3500						1 176 000
									50000			50000
										4	4000	16000
		Shuma:			336				50000			1,242,000

Mbyllet me nr. rendor 1

Republika e Shqipërisë

Rrethi: Lushnjë

Komuna: Dushk
Fshati Dushk Peqin

Lista e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Rrogozhinë Lushnjë
Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë arë, truall dhe investime nr. (1)

Nr	Pronarët			Nr.i parcel.	Sipërf në m2	Çmim l/m2	Sip.m2 truall	Çmim lek/m2	Inv/ lekë	Vlera në lekë
	Emri	Atësia	Mbiem.							
					Tokë/ Bujqë					
	Artan	Zenel	Guçe		66	750	0	0	0	49500
				260/21	0		524	3500	0	1834000
	Fatos	Myfit	Maliqaj		0		0	0	7397065	7397065
	Shuma				66		524			9280565

V E N D I M
Nr.329, datë 17.5.2001

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “MILOT-LEZHË”, NË RRETHIN E LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për inters publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Lezhë, në rrethin e Lezhës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët do të shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një përfaqe të përgjithshme 4 828 m2 tokë/arë. 1m2 tokë/arë është vlerësuar me 600.9 lekë m2, dhe vlera e përgjithshme arrin shifrën 2 928 745 (dy milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2001, zëri “shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit .
 5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2001.
 6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Lista e personave që shpronësohen për efekt të segmentit rrugor
Milot-Lezhë-Qytet Lezhë

Nr	Pronarët			Nr. i parcelës	Sipërf. në m2	Çmimi l/m2	Kulturë bujqësore	Totali lekë
	Emri	Atësia	Mbiemri					

					600.9		
1	Gjek	Martin	Leka	180/7	666		
2	Lula	Kol	Lleshi	104/15	1099		
3	Mark	Gjok	Ivanaj	104/1	1064		
4	Vat	Marash	Ivanaj	105/1	1179		
5	Rrok	Gjok	Narkaj	140/7	130		
6	Pashk	Zef	Dodaj	140/6	294		
7	Pjetër	Zef	Cali	140/10	315		
8	Mark	Nikoll	Malaj	95/12	81		
	Shuma			4828	600.9		2901145

Shpenzimet e publikimit për këtë segment rrugor kapin shifrën prej 27 600 lekë.

Totali: 2928745

Mbyllet me numër rendor 8(tetë)

U D H Ë Z I M **Nr.4, datë 17.5.200**

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBIKQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 7, 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë i pikës 2 ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga persona, fizikë ose juridikë, të pajisur me licencën përkatëse. Mbikëqyrësi i punimeve caktohet nga kryetari i entit prokurues”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M **Nr. 33, datë 9.5.2001**

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 14.3.2001 dhe 20.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18 Akti që i përket:

KËRKUES:Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfaqësuar nga zotërinjtë Altin Sinella dhe Stefan Papagjoni, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, me autorizim.
2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga zoti Arben Imami, Ministër i Drejtësisë.
3. Partia Aleanca Demokratike, përfaqësuar nga zoti Arben Demeti.
4. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, përfaqësuar nga zoti Ylber Valteri.
5. Partia Lëvizja e Legalitetit, përfaqësuar nga zoti Shaqir Hasani.
6. Partia Socialdemokrate, përfaqësuar nga zoti Afrim Çenga.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes “por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera”, në fjalinë e dytë të nenit 23 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Partitë politike, nuk përfshihen në rrethin e subjekteve që kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, të parashikuara në nenin 163 të Kushtetutës.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik - financiar, është organ i depolitizuar dhe i departizuar dhe nuk mund të shndërrohet në një organ hetimi për partitë politike.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe pasi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi, fillimisht, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e nenit 23 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, në të cilin thuhet: “K Kontrolli i Lartë i Shtetit është organi kompetent i ngarkuar me funksionin e kontrollit financiar mbi partitë. Ky kontroll nuk do të kufizohet vetëm në pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike, por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë të ushtrojë kontroll financiar mbi partitë politike para dhe pas fushatave elektorale.”

Në seancë gjyqësore kërkuesi e ka kufizuar objektin e kërkesës për antikushtetutshmëri vetëm në fjalinë e dytë të dispozitës së sipërcituar dhe, konkretisht, në ushtrimin e kontrollit mbi dhuratat dhe ndihmat që përfitojnë partitë politike, duke mos e konsideruar si të papajtueshëm me Kushtetutën kontrollin financiar mbi partitë politike në pjesën që ato përfitojnë nga Buxheti i Shtetit.

K Kontrollit i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik-financiar, e shtrin veprimtarinë e tij mbi një rreth të caktuar subjektsh juridike. Sipas nenit 163 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, subjektet që i nënshtrohen kontrollit të këtij organi janë institucionet shtetërore për veprimtarinë e tyre ekonomike, organet e pushtetit qendror e vendor në mënyrën e përdorimit dhe të mbrojtjes së fondeve shtetërore, si dhe personat juridikë në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Partitë politike, duke qenë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta politike, në aspektin kushtetues dhe ligjor nuk mund të njësohen me institucionet shtetërore apo me personat e tjerë juridikë shtetërorë. Në kuptim të dispozitës kushtetuese të sipërcituar, partitë politike mbeten jashtë grupimit të këtyre subjekteve juridike për t’u kontrolluar për veprimtarinë e tyre ekonomike dhe financiare.

Duke e shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se edhe dhuratat dhe ndihmat që partive politike i vijnë nga parti apo bashkime ndërkombëtare partish,

organizata e fondacione politike vendase apo të huaja, të cilat njihen si burime financiare e materiale të tyre, nuk mund të jenë objekt kontrolli i këtij organi kushtetues.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas kuptimit që i ka dhënë Kushtetuta dhe vetë ligji i tij organik, është konceptuar si një organ që ka si objekt kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirëadministrimit financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare. Prandaj, ndihmat dhe dhuratat që partitë politike përfitojnë nga donatorë të ligjshëm dhe që nuk kanë të bëjnë me fondet publike, të analizuara edhe në këtë aspekt, dalin jashtë objektit të këtij kontrolli të specializuar.

Mbi bazën e argumentave të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ushtrimi i kontrollit ekonomiko-financiar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi mënyrën se si partitë politike i përfitojnë këto dhurata apo ndihma, që parashikohet në nenin 23 të ligjit “Për partitë politike”, nuk gjen mbështetje në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Duke marrë shkas nga mënyra e formulimit të fjalisë së dytë të nenit 23 të ligjit “Për partitë politike” si dhe nga fakti se fusha e veprimtarisë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucion i kontrollit ekonomiko-financiar, nuk parashikohet vetëm në nenin 163 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme edhe parashkrimin e argumenteve të mëposhtme, pasi nuk mund të konkludojë për kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, pa analizuar në tërësi kuptimin që në thelb përmbajnë nenet 9, 158, 162 dhe 164 të saj.

Partitë politike kanë personalitet juridik dhe, sipas ligjit, disponojnë edhe pasurinë e tyre, në të cilën përfshihen kuotat e anëtarësisë, çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme, si dhe ndihmat financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit. Mospërfshirja e partive politike në rrethin e subjekteve që kontrollohen, sigurisht nuk e bën të pakontrollueshme veprimtarinë e tyre ekonomiko-financiare.

Partitë politike, duke mos u kontrolluar nga pikëpamja financiare nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për ndihmat apo dhuratat që ato përfitojnë nga burime të ligjshme, nuk mund t’i shmangin financat e tyre nga transparenca publike. Neni 9 pika 3 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, detyron partitë politike që burimet financiare, si dhe shpenzimet e tyre t’i bëjnë kudoherë publike. Prandaj, mosrespektimi i këtij detyrimi kushtetues në kuptim edhe të nenit 131 shkronja “d” të Kushtetutës përbën juridiksion kushtetues dhe njërën nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur për kushtetutshmërinë e veprimtarisë së partive politike.

Një koncept të qartë ka sanksionuar Kushtetuta edhe lidhur me kontrollin mbi Buxhetin e Shtetit. Kështu nenet 158 e 164, dispozita të cilat lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e zbatimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe me dëgjimin e raportit përpara se Kuvendi ta miratojë këtë Buxhet, kanë ngarkuar Kontrollin e Lartë të Shtetit, si i vetmi institucion për t’i ushtruar këto kompetenca. Pikërisht nga raportimi që Kontrolli i Lartë i Shtetit bën përpara Kuvendit lidhur me zbatimin e Buxhetit të Shtetit nga subjektet që kanë përfituar prej tij, ku përfshihen edhe partitë politike, buron edhe e drejta e këtij organi të specializuar, për të ushtruar kontrollin financiar mbi pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike.

Ushtrimi i kësaj kompetence të karakterit kushtetues sigurisht që nuk bie ndesh me konceptin që Kushtetuta ka krijuar për Kontrollin e Lartë të Shtetit, si dhe njëkohësisht nuk mund të prekë as pavarësinë e këtij institucioni të lartë të kontrollit ekonomik e financiar, vartësia e vetme e të cilit, në kuptim të nenit 162, është Kushtetuta dhe ligji.

Mbi bazën e të gjithë argumenteve të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është e drejtë dhe duhet pranuar.

Nisur nga fakti se me pranimin e kërkesës, fjalia e dytë e nenit 23 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” do të rezultojë e paplotë, Gjykata Kushtetuese çmon se mbetet në vlerësimin e ligjvënësit formulimi më i saktë i dispozitës konkrete nga pikëpamja gjuhësore dhe e teknikës legjislativë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shprehjes “por do të mbulojë edhe dhuratat dhe ndihmat e përfituara në rrugë të tjera”, në fjalinë e dytë të nenit 23 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Pranimi me shumicë votash i kërkesës së Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe përjashtim i këtij organi nga detyrimi për të kontrolluar prejardhjen e dhuratave ose të ndihmave që përfitojnë partitë politike në rrugë të tjera, pa i kushtuar rëndësi edhe rasteve të financimeve të kundërligjshme, përbën një precedent tepër të rrezikshëm, i cili iu krijon kushtet dhe mundësitë disa grupeve të fuqishme të ushtrojnë presion dhe të disktojnë mbi vullnetin e popullit dhe votën e tij të lirë.

Për mendimin tim, shteti nuk duhet të qëndrojë indiferent ndaj këtyre fenomeneve negative. Aktualisht, tek ne, përveç Kontrollit të Lartë të Shtetit, nuk ka ndonjë organ tjetër shtetëror, të paanshëm që mund të reagojë me objektivitet ndaj kësaj dukurie negative, siç janë financimet e tërthorta nëpërmjet dhuratave ose ndihmave të tjera materiale, që mund t’i ofrohen një partie politike, me qëllim që të fitojë padrejtësisht në garën elektorale dhe pastaj kjo të kthehet në vegël për zbatimin e një politike antipopullore dhe antikombëtare.

Kush tjetër përveç Kontrollit të Lartë të Shtetit që zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, i cili përfaqëson unitetin e popullit, mund të jetë i interesuar të evidentojë më mirë rastet kur një parti politike nuk zbaton parimin kushtetues për bërjen publike të burimeve financiare dhe të shpenzimeve të saj? Përgjigjja me të drejtë, sipas mendimit tim është kjo: Që nuk ka dhe nuk mund të ketë organ tjetër më të paanshëm se Kontrolli i Lartë i Shtetit, aq më tepër që drejtimi i tij i është besuar një përfaqësuesi të opozitës.

Konkluzioni i shumicës së partitë politike si bashkime vullnetare individësh nuk janë persona juridikë publikë, është i drejtë, por kjo nuk do të thotë se ata, si persona juridikë nuk përfshihen në rrethin e atyre subjekteve që financohen nga shteti, në vështrim të shkronjës “c” të nenit 163 të Kushtetutës. Kjo për arsye se pavarësisht nga karakteri i tyre privat, ata ushtrojnë kryesisht veprimtari publike, e cila reflektohet dhe është përcaktuese në drejtimin politik të vendit.

Për rrjedhojë, i gjithë aktiviteti i tyre ekonomik e financiar dhe jo vetëm një pjesë e tij, duhet t’i nënshtrohet kontrollit shtetëror.

Si përfundim, unë nuk gjej ndonjë shkelje me karakter kushtetues që ky kontroll i përgjithshëm, duke përfshirë edhe dhuratat ose ndihmat që u afrohen partive politike në rrugë të tjera, të ushtrohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ashtu siç parashikohet nga neni 23 i ligjit të tyre organik.

V E N D I M Nr. 43, datë 18.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i ““
Kristofor Peçi, Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 02.2.2001 dhe 13.2.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti që i përket:

KËRKUESE: Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarëve “Pronësi me drejtësi”, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.
2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.
3. Shoqata e qiramarrësve të banesave shtetërore ish-pronë private, përfaqësuar nga zotërinjtë Pirro Polo, Pertef Deveja e Riza Kamberi, me autorizim.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues i nenit 4 të ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha””, ndryshimin e paragrafeve të dytë e të tretë të nenit 1 të të njëjtit ligj dhe shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”.

Për shfuqizimin e këtyre dispozitave, kërkuesi parashtron këto shkaqe:

1. Neni 4 i ligjit cenon të drejtën e pronësisë të sanksionuar nga nenet 41 e 42 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ai prek tërësisht rolin dhe rëndësinë e vullnetit të palëve me anë të kontratës;

- Ky nen vjen në kundërshtim me nenin 11/1 dhe 41/4 të Kushtetutës sepse cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe bën shpronësim pa shpërblyer, sepse të detyron të marrësh qira 100 lekë për një pronë, që mund të jepet lehtësisht me qira për 20 mijë lekë.

- Neni 4 është i njëanshëm sepse zgjidh vetëm problemin e qiramarrësve pa patur parasysh se mospagimi i qirasë përbën një problem social për ata që e pësojnë.

2. Në nenin 1 shprehja “Privatizimi i këtyre banesave kryhet sipas kriterëve ... duke i shtuar tarifës indeksin e korigjimit të çmimeve”, duhet të shfuqizohet si antikushtetues se të le përshtypjen që këto banesa që në fakt u janë kthyer pronarëve, do të privatizohen në favor të qiramarrësve.

3. Shfuqizimi i nenit 4 nuk duhet të shërbejë për të sjellë në fuqi nenin 10 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995, sepse për të njëjtat arsye edhe kjo dispozitë është antikushtetuese.

4. Terminologjia e përdorur “banesa shtetërore ish-pronë private” dëshmon për një tendencë tepër të rrezikshme, në atë të mosnjohjes së kthimit të pronave pronarëve. Ky term të zëvendësohet me termin “banesa private ish-pronë shtetërore”, që i përgjigjet më mirë njëmendësisë së sotme.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.5, datë 27.2.1997, ka shfuqizuar nenin 11 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, duke rekomanduar që të rregullohet me një dispozitë tjetër detyrimi i qiramarrësve të banesave ish-pronë private për pagimin e qirasë brenda fuqisë së tyre ekonomike, deri në zgjidhjen e strehimit të tyre, ndërsa diferenca e masës së qirasë të përballohet nga shteti.

Sipas nenit 4 të ligjit nr.8647, datë 29.7.2000, i cili ndryshon nenin 10 të ligjit nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, problemi i qirasë për banesat ish-pronë private rregullohet në këtë mënyrë: “Deri në zgjidhjen e strehimit, qytetarët e pastrehë që banojnë në

banesa ish-pronë private, do të paguajnë qira sipas tarifave që paguanin në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Kërkuesi pretendon se përmbajtja e këtij neni është antikushtetues sepse i privon ish-pronarët nga e drejta për të gëzuar frytet e sendit të dhënë me qira.

Gjykata Kushtetuese çmon se ligji nr.8647, datë 24.7.2000, duke bërë disa ndryshime në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, ka për qëllim që të ndihmojë sa të jetë e mundur familjet që banojnë me qira në banesa ish-pronë private, deri në zgjidhjen e strehimit të tyre. Një qëllim të tillë ka edhe neni 4 i ligjit, i cili ndryshon nenin 10 të ligjit të mëparshëm, duke vendosur tarifa të ulta qiraje për të ndihmuar qiramarrësit, për të krijuar mundësi reale për zgjidhjen e strehimit të tyre dhe njëkohësisht lirimit të banesave për ish-pronarët. Caktimi i tarifave të tilla është në përputhje edhe me vendimin nr.5, datë 27.2.1997 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin arsyetohet se masa e qirasë duhet të jetë brenda fuqisë ekonomike të këtyre familjeve.

Përsa i përket përcaktimit tjetër të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese që diferenca e masës së qirasë të përballohet nga shteti, neni 4 i ligjit nuk bën fjalë dhe pikërisht për këtë kërkuesi pretendon se ai është antikushtetues. Por, fakti i mospërmendjes së detyrimit që shteti do të marrë përsipër të realizojë, nuk e bën përmbajtjen e këtij neni antikushtetues. Kjo dispozitë përcakton masën e qirasë që do të paguajnë qytetarët e pastrehë si qiramarrës, por nuk rregullon masën në tërësi të qirasë për këto banesa dhe pjesën e kontributit të shtetit. Përballimi nga shteti i diferencës së masës së qirasë, e cila nuk përcaktohet në nenin objekt kërkesë, mund të bëhet me dispozita të tjera. Vetë ligji nr.8647, datë 24.7.2000 në nenin 5, përcakton se ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për procedurat e veprimeve që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banësive, si dhe për sigurimin e burimeve financiare.

E parë çështja në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese, e cila vepron në rolin e ligjvënësit negativ, nuk mund ta pranojë kërkesën për shfuqizimin e nenit 4 si antikushtetues, por ajo, me këtë rast, konfirmon edhe njëherë qëndrimin e mbajtur me vendimin e saj nr.5, datë 27.2.1997 që për këto banesa ligjvënësi të caktojë një masë qiraje duke theksuar që diferenca do të përballohet nga shteti. Në këtë mënyrë do të zgjidhet plotësisht problemi i qirasë së këtyre banësive, i cili do të vazhdojë deri në zgjidhjen e strehimit për qytetarët e pastrehë, por pa dëmtuar asnjërin palë. Neni 4 i ligjit nuk ka kufizim ose cenim të të drejtave kushtetuese të ish-pronarëve, siç pretendohet në kërkesë. Për qiranë e këtyre banësive ka një ometim (boshllëk ligjor) sepse në asnjë akt normativ nuk përcaktohet mënyra e përballimit të diferencës së qirasë. Por, ky nen nuk bëhet pengesë që ligjvënësi të nxjerrë një dispozitë tjetër për të plotësuar këtë boshllëk dhe për të përmbushur edhe detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin 181/1 të Kushtetutës.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për shfuqizim të fjalisë së dytë të nenit 1 të ligjit objekt kërkesë, për shkak se sipas tij le përshtypjen se këto banesa ish-pronë private do të privatizohen në favor të qiramarrësve, është i gabuar. Ky nen nuk bën fjalë për banesat ish-pronë private, por për banesat që do t’u sigurohen qytetarëve të pastrehë nëpërmjet Entit Kombëtar të Banësive, duke u garantuar atyre edhe të drejtën e privatizimit sipas ligjit. Në këto kushte, ky pretendim nuk ka objekt, prandaj duhet rrëzuar.

Kërkuesi ka parashtruar edhe një shkak tjetër për të shfuqizuar si antikushtetuese dispozitat e ligjit nr.8647, datë 24.7.2000 dhe pikërisht terminologjinë e përdorur: “banesa shtetërore ish-pronë private”, duke theksuar se kjo dëshmon për një tendencë tepër të rrezikshme, për mosnjohje të pronës së ish-pronarëve. Zëvendësimi i këtij termi me fjalët “banesa private ish-pronë shtetërore”, siç pretendohet në kërkesë, nuk mund të përbëjë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, përderisa përdorimi i termave të tillë nuk çënon thelbin e ndonjë të drejte. Për rastin e kthimit të pronave ish-pronarëve nuk ka rëndësi emërtimi i këtyre pronave, por garancitë ligjore për të realizuar plotësisht një kthim të tillë.

Gjykata Kushtetuese duke vlerësuar përmbajtjen e nenit 4 të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe njëkohësisht duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në vendimin e mëparshëm të saj, për plotësimin e boshllëkut ligjor, i përmbahet plotësisht kompetencave të saj të garantuara nga Kushtetuta, me qëllim që ky problem i rëndësishëm social të zgjidhet drejt nga organet përkatëse shtetërore.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131/a të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 7.6.2001
Doli nga shtypi më 9.6.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë